




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 Nr. 112/02-8269

Datë: 03.04.2018

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në neni 60 paragrafi 60.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me Rregulloren 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, merr këtë:

### V E N D I M

1. Formohet Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil (KPSHC) për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Profesionale

Përbërja e KPSHC-ës është:

1. Merita Bokshi - Kryesuese e Komisionit (Drejtoresh, Shkolla "Kadri Kusari", Gjakovë)
  2. Berat Bejtullahu - anëtar (Drejtor, Shkolla "Yll Morina", Gjakovë)
  3. Gjoke Osmani - anëtar (Drejtor, Shkolla "Selman Riza", Gjakovë)
  4. Armend Behluli - anëtar (Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Gjakovë)
  5. Mergim Delija - anëtar (Drejtor, Shkolla "Sh. Bardhaniq", Gjakovë)
2. KPSHC fillon punën e shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve të paraqitur, menjëherë pas mbylljes së konkursit, dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së rekrutimit.

### A r s y e t i m

Komisioni është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, përcaktimin e orarit të përzgjedhjes, mbajtjen e testeve të përzgjedhjes, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshëm.

Me qëllim të rrespektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë vend të punës, u caktua komisioni si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të KPSHC-ës
- Zyrës së Personelit
- Arkivit.



Kryetari i Komunës së Gjakovë

Ardian Giini